



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

VENDIM

Nr. 34, datë 30.01.2026

**PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË KOMUNKIMIT PËR SISTEMIN GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, neneve 91 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Komunikimit për gjykatat në Republikën e Shqipërisë dhe shtojcës 1 bashkëngjitur si pjesë integrale e tij.
2. Pika e kontaktit raporton çdo 3 muaj pranë Drejtorisë për Marrëdhëniet me Publikun, Median dhe Botimet në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për zbatimin e Planit të Komunikimit, sipas formatit të raportimit, shtojcë e Planit të Komunikimit.
3. Anëtari përgjegjës për marrëdhënien me median me publikun, raporton pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, një herë në vit për zbatimin e këtij Plani Komunikimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqe zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



PLANI I KOMUNIKIMIT PËR GJYKATAT 2025-2027

Hyrje

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si institucioni përgjegjës për qeverisjen e sistemit gjyqësor dhe garantimin e pavarësisë, integritetit dhe profesionalizmit të gjyqtarëve në Shqipëri, ushtron veprimtarinë e tij i udhëhequr nga parimi se, transparenca dhe komunikimi efektiv janë thelbësorë për forcimin e shtetit të së drejtës dhe rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Krahas nevojës për një sistem gjyqësor të paanshëm dhe të pavarur, KLGJ është e vetëdijshme për domosdoshmërinë e komunikimit të qartë të rolit, funksioneve dhe aktiviteteve të gjykatave. Gjykatat, si një nga shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës, kanë përgjegjësinë për të siguruar që qytetarët dhe media, shoqëria civile apo aktorë të tjerë të interesuar të kuptojnë se si funksionojnë proceset gjyqësore, si merren vendimet dhe si respektohen të drejtat themelore të individit tek jepet drejtësi.

Gjykatat nuk janë vetëm organe vendimmarrëse që zgjidhin mosmarrëveshjet mes palëve, por edhe institucione publike që ndërveprojnë me qytetarët, median dhe aktorë të tjerë shoqërorë. Prandaj besimi i publikut në drejtësi nuk ndërtohet vetëm përmes vendimeve të drejta, por edhe përmes transparencës, kuptueshmërisë dhe komunikimit institucional të përgjegjshëm. Reforma në drejtësi dhe procesi i integritetit europian ka rritur ndjeshëm pritshmëritë e qytetarëve dhe kërkesën institucionale për një gjyqësor të hapur, të përgjegjshëm dhe të kuptueshëm.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vijon të mbetet i angazhuar për të rritur transparencën e sistemit gjyqësor, dhe të sigurojë që të gjithë aktorët institucionalë, media, shoqëria civile dhe qytetarët të kenë akses në sistemin gjyqësor, të përfitojnë nga shërbimet e shumta që ofrohen dhe të kenë besim se ky sistem është i pavarur, i paanshëm dhe garanton sundimin e së drejtës dhe i shërben interesit publik.

Në periudhën 2022–2024, përmes zbatimit të planit të komunikimit, ndërhyrjeve të strukturuar dhe miratimit të udhëzimeve përkatëse, janë hedhur bazat për një qasje më të organizuar, më transparente dhe më të kuptueshme të gjykatave ndaj publikut dhe aktorëve të interesit

Ky Plan i ri Komunikimi synon të ndërtojë një qasje të unifikuar, proaktive dhe të bazuar në standardet evropiane për mënyrën se si gjykatat komunikojnë vendimmarrjen, proceset, sfidat dhe rezultatet e tyre. Ai ka për qëllim të konsolidojë praktikën e mira të krijuara gjatë periudhës 2022–2024, të adresojë boshllëqet e evidentuara dhe të sigurojë një standard të unifikuar komunikimi në të gjitha gjykatat. Duke rritur aksesin e publikut në informacion dhe duke forcuar marrëdhëniet me median, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar, KLGJ synon të konsolidojë besimin e qytetarëve te institucionet e drejtësisë dhe nga ana tjetër të garantojë e mbrojë pavarësinë e gjyqësorit përmes një komunikimi të qartë, transparent dhe profesional.

Plani i komunikimit është mekanizmi dinamik që ndihmon gjyqësorin të menaxhojë në mënyrë efektive rrjedhën e informacionit, të mbështesë vlerat thelbësore të pavarësisë dhe paanshmërisë dhe të funksionojë si një degë e respektuar dhe e kuptuar e pushtetit brenda një shoqërie demokratike.

Plani i komunikimit të gjykatave është një pikënisje për të strukturuar mënyrën sesi ato i përqasen publikut dhe aktorëve të tjerë të interesit gjatë një procesi komunikimi e ndërveprimi dhe ka si qëllim të mbështesë zbatimin e Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor. Plani i Komunikimit ofron zgjidhje novatore dhe qasjet më të mira për të komunikuar në mënyrë efektive duke shfrytëzuar të gjithë mjetet

e komunikimit që mundëson teknologjia. Ai do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme në varësi të zhvillimeve për t'u përshtatur me situata apo prioritete që mund të paraqiten në të ardhmen dhe i takon të gjithë aktorëve që ta jetësojnë atë.

Plani i Komunikimit shoqërohet me një Plan Veprimi duke dhënë ide dhe mjete praktike për ta bërë komunikimin më të lehtë, më të kuptueshëm dhe me sa më shumë ndikim në drejtim të rritjes së transparencës, nivelit të informimit, cilësisë së shërbimeve, profesionalizmit dhe për rrjedhojë, besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Ai përcakton parimet dhe përparësitë e komunikimit, objektivat, grupet e synuara, mesazhet kryesore dhe mjetet e nevojshme të komunikimit.

MISIONI:

Misioni i KLGJ-së është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut.

VIZIONI:

Drejtësia në Shqipëri do të arrihet kur të gjithë qytetarët të kenë besim se do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë sipas ligjit, nga një sistem gjyqësor i pavarur, etik dhe efikas.

Parimet kryesore të planit të komunikimit

Parimet e komunikimit të gjykatave me publikun., median dhe aktorë të tjerë të interesuar synojnë të rrisin besimin e publikut te gjykatat, të mbrojnë integritetin institucional dhe të krijojnë një komunikim efektiv dhe të përgjegjshëm me qytetarët dhe median.

Transparenca: Gjykatat duhet të ofrojnë informacion të qartë dhe të aksesueshëm për vendimet, proceset dhe funksionimin e sistemit gjyqësor. Nëse qytetarët kuptojnë mënyrën se si funksionon dhënia e drejtësisë, ata do të kenë më shumë besim në sistemin gjyqësor.

Respekti për pavarësinë e gjykatave: Komunikimi i gjykatave duhet të jetë i pavarur nga ndikimet politike ose presionet nga çdo palë e tretë. Mesazhet duhet të fokusohen tek ligji, procedurat dhe vendimet, pa preferenca ose paragjykime politike dhe në çdo rast duhet të mbrojnë pavarësinë e gjykatave.

Saktësia: Informacioni i publikuar duhet të jetë korrekt, i verifikuar dhe i paanshëm. Çdo gabim apo informacion i pasaktë mund të dëmtojë besimin publik dhe integritetin e gjykatës.

Reagimi i Shpejtë: Gjykatat duhet të përgjigjen shpejt ndaj pyetjeve të medias, publikut dhe aktorëve të tjerë të interesuar, veçanërisht në raste me rëndësi publike. Reagimi i shpejtë ndihmon në parandalimin e spekulimeve dhe përhapjes së lajmeve apo informacioneve të rreme.

Gjuha e Thjeshtë dhe e Kuptueshme: Informacioni duhet të transmetohet në një gjuhë të qartë, të kuptueshme për publikun e gjerë. Terminologjia shumë teknike duhet të evitohet, pasi qytetarët kanë nevojë të kuptojnë vendimet dhe funksionimin e gjykatës në një gjuhë sa më të thjeshtë.

Qëndrueshmëria e Mesazheve: Mesazhet kryesore duhet të jenë të qëndrueshme dhe të harmonizuara në të gjitha komunikimet e gjykatës. Konsistenca forcon kredibilitetin dhe ndihmon në krijimin e një imazhi të besueshëm institucional.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale: Në çdo rast gjykatat duhet të garantojnë integritetin e sistemit gjyqësor dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve të përfshira. Prandaj informacioni duhet të trajtohet konfidencialisht dhe në përputhje me ligjin.

Bashkëbisedimi me shoqërinë civile dhe median: Bashkëpunimi institucional synon të mundësojë informim korrekt dhe të balancuar, jo të shndërrojë gjykatat në aktorë mediatikë apo palë në debat publik. Ky dialog duhet të synojë të ndërtojë marrëdhënie profesionale dhe të qëndrueshme me median , shoqërinë civile apo aktorë të tjerë të interesuar.

Qëllimi i planit të komunikimit

Qëllimi i Planit të Komunikimit është të përcaktojë mënyrat dhe mjetet e nevojshme të komunikimit, objektivat, audiencat dhe mesazhet kryesore, gjatë një harku kohor 2 vjeçar (2026 – 2027), në mënyrë që të rritet niveli i aksesit në informacion që publiku dhe media duhet të kenë mbi gjykatat, në funksion të rritjes së besimit të publikut në veprimtarinë e tij.

Plani i komunikimit të gjykatave është rrjedhojë e Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, e në këtë kuptim, qëllimi dhe objektivat e këtij plani janë në përputhje me synimet dhe objektivat strategjike që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për sistemin gjyqësor. Gjithashtu ai është harmonizuar edhe me synimet dhe objektivat e Planit Strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë 2025-2027, dhe Udhërrëfyeni për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025-2027.

Qëllimi i Planit të Komunikimit:

Rritja e besimit të publikut dhe e transparencës në sistemin gjyqësor nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe mënyrave novatore të komunikimit dhe informimit midis gjykatës, publikut, medias, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të interesuar

Synimi Strategjik 5 i Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë 2025-2027

SYNIMI 5:

Zbatimi dhe Përmirësimi Strategjive për Komunikimin e Jashtëm

- 5.1 Rritja e transparencës dhe aksesit në veprimtarinë e sistemit gjyqësor.
- 5.2 Përmirësimi i komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe me mediat për të siguruar një marrëdhënie proaktive, transparente e informuese.
- 5.3 Fuqizimi i ndërveprimit të KLGJ-së me gjykatat për zbatimin e planit të komunikimit për sistemin gjyqësor.

Synimi Strategjik 8 i Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025-2027.

<i>SYNIMI 8:</i> <i>Rritja e besimit të publikut</i>	8.1 Informimi i publikut për masat e marra 8.2 Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies duke publikuar rezultatet e arritura 8.3 Përmirësimi i shërbimeve ndaj publikut
---	---

Shtyllat kryesore të planit të komunikimit

Në mënyrë që qëllimi kryesor të arrihet, katër shtylla themelore strategjike janë parashikuar.



SHTYLLA I - QEVERISJA DHE KOORDINIMI I KOMUNIKIMIT TË GJYKATAVE

Kjo shtyllë synon përforcimin dhe konsolidimin e një kuadri të qartë qeverisjeje të komunikimit të sistemit gjyqësor me publikun, median dhe aktorë të tjerë të interesuar, ku rolet, përgjegjësitë, mekanizmat e koordinimit janë të përcaktuara qartë dhe funksionojnë rrjedhshëm si dhe burimet buxhetore dhe njerëzore janë të garantuara. Bazuar në përvojën e fituar gjatë periudhës 2022–2024, fokusi i kësaj shtylle për periudhën 2025–2027 është kalimi nga praktika të veçanta dhe jo standarde drejt një qasjeje të unifikuar dhe të koordinuar të komunikimit në të gjitha gjykatat.

Komunikimi i gjykatave institucionalizohet dhe nuk trajtohet më si veprimtari ndihmëse, por si funksion i domosdoshëm i qeverisjes së sistemit gjyqësor, i lidhur drejtpërdrejt me transparencën, llogaridhënien dhe rritjen e besimit të publikut. Në këtë drejtim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron rol udhëheqës, koordinues dhe garantues të burimeve buxhetore dhe njerëzore, ndërsa gjykatat zbatojnë standarde të njëjta komunikimi në marrëdhënie me publikun, median, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar.

SHTYLLA II - TRANSPARENCA DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

Kjo shtyllë ka në fokus garantimin e aksesit të barabartë në informacionin e saktë dhe të kuptueshëm rreth veprimtarisë së gjykatave dhe sistemit gjyqësor në përgjithësi. Duke u mbështetur në materialet informuese, praktikat dhe instrumentet e zhvilluara në periudhën 2022–2024, Plani i Komunikimit 2025–2027 synon standardizimin e përmbajtjes dhe të mënyrës së informimit të publikut në të gjitha gjykatat.

Informimi i publikut duhet të orientohet drejt nevojave konkrete të qytetarëve, duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe formate praktike, me fokus të veçantë në shpjegimin e procedurave gjyqësore dhe shërbimeve të ofruara nga gjykatat. Transparenca trajtohet si standard dhe jo si një praktikë që zbatohet nga rasti në rast, duke synuar rritjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

SHTYLLA III - KANALET DHE TEKNOLOGJIA E KOMUNIKIMIT

Kjo shtyllë synon zhvillimin e mëtejshëm dhe përdorimin e qëndrueshëm të formave e kanaleve bashkëkohore të komunikimit si mjet kryesor për informimin dhe ndërveprimin me publikun. Në vijim të zhvillimit të objektivave të vendosura në planin e veprimit 2022–2024 në lidhje me përdorimin e faqeve të internetit, rrjeteve sociale dhe mjeteve audiovizive, fokusi i periudhës 2025–2027 është konsolidimi i një ekosistemi të unifikuar digjital të komunikimit të gjykatave me publikun, median, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Gjykatat duhet të përdorin teknologjinë e informacionit në mënyrë të strukturuar, të planifikuar dhe të matshme, duke siguruar përditësim të rregullt të informacionit, akses në kohë reale dhe komunikim të qartë me publikun, median, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar. Kanalet digjitale duhet të trajtohen si mjete të përhershme të komunikimit institucional dhe jo si mjete sporadike.

SHTYLLA IV - NDËRVEPRIMI ME KOMUNITETIN DHE RITJA E BESIMIT TË PUBLIKUT

Kjo shtyllë synon afrimin e sistemit gjyqësor me komunitetin dhe ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme besimi midis gjykatave, qytetarëve, shoqërisë civile, medias e aktorë të tjerë. Duke u mbështetur në objektivat e përcaktuara në planin e veprimit 2023-2025, si organizimi i aktiviteteve publike dhe themelimi i Javës së Drejtësisë, periudha 2025–2027 synon forcimin dhe institucionalizimin e këtyre aktiviteteve si pjesë përbërëse e komunikimit të sistemit gjyqësor me publikun dhe aktorët e tjerë.

Gjykatat duhet të angazhohen në zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere, edukative dhe informuese që promovojnë njohjen e rolit të gjykatës në shoqëri, rëndësinë e shtetit të së drejtës, edukimin ligjor të qytetarëve dhe rritjen e transparencës përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me publikun. Ndërveprimi me komunitetin nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile trajtohet si mekanizëm kyç për rritjen afatgjatë të besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

Objektivat e planit të komunikimit

Shtylla	Funksioni dhe objektivat konkretë
SHTYLLA I: QEVERISJA DHE KOORDINIMI I KOMUNIKIMIT TË GJYKATAVE	<i>Zbatimi praktik dhe i unifikuar i Planit Strategjik dhe Udhëzuesit Standard në nivel gjykatash</i>
	1.1 Ndjekja e ecurisë së zbatimit uniform të Udhëzuesit për marrëdhëniet me publikun dhe median nga ana e gjykatave dhe KLGJ 1.2 Institucionalizimi i figurave/roleve kryesore dhe zbatimi standard i përgjegjësi (Gjyqtari i Medias, Nëpunësi i Marrëdhënieve me Median dhe Publikun (NMMP), Anëtar i KLGJ përgjegjës për MMP 1.3 Bashkërendimi i aktiviteteve përmes zhvillimit të takimeve 3 mujore të pikave të kontaktit dhe Anëtarit të KLGJ për MMP 1.4 Ndjekja e ecurisë së zbatimit të Planit përmes raportimit vjetor të Anëtarit të KLGJ 1.5 Garantimi i burimeve buxhetore për financimin e aktiviteteve të Planit 1.6 Koordinimi i qëndrimeve publike për çështje me interes publik ndërmjet KLGJ dhe gjykatave 1.7 Bashkërendimi KLGJ – gjykatë i komunikimit në situata kritike 1.8 Diskutimi i çështjeve të marrëdhënieve me median dhe publikun në takimet periodike të lidhshpimit të gjykatave

Shtylla	Funksioni dhe objektivat konkretë
<i>SHTYLLA II</i> <i>TRANSPARENCA DHE INFORMIMI I PUBLIKUT</i>	<i>Sigurimi i aksesit real, të barabartë dhe të kuptueshëm në informacion në përputhje me parashikimet ligjore.</i>
02  TRANSPARENCA DHE INFORMIMI I PUBLIKUT	2.1 Publikimi i informacionit pa kërkesë (procedura, shërbime, struktura) sipas parashikimeve në Udhëzues 2.2 Informimi në gjuhë të thjeshtë për procedurat gjyqësore 2.3 Informimi mbi ndihmën juridike dhe tarifat gjyqësore 2.4 Informimi i përshtatur për të mitur, PAK, grupe në nevojë 2.5 Informimi i publikut për masat e marra për rritjen e efikasitetit të pushtetit gjyqësor 2.6 Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies duke publikuar rezultatet e arritura
<i>SHTYLLA III - KANALET DHE TEKNOLOGJIA E KOMUNIKIMIT</i>	<i>Zbatimi praktik kanaleve të komunikimit të parashikuara në Planin Strategjik dhe Udhëzues.</i>
03  KANALET DHE TEKNOLOGJIA E KOMUNIKIMIT	3.1 Rritja e aksesit në kohë reale në informacion nëpërmjet administrimit dhe përditësimit të faqeve zyrtare të internetit 3.2 Institucionalizimi i përdorimit të rrjeteve sociale nëpërmjet hartimit të media-planeve vjetore për rrjetet sociale 3.3 Rritja e përçimit të informacionit nëpërmjet përgatitjes dhe përdorimit të videove shpjeguese, tutoriale, njoftime të shkurtra etj. 3.4 Promovimi i mënyrave të përfutimit të informacionit gjyqësor përmes përdorimit të QR, posterave dhe mënyrave të tjera digjitale 3.5 Vërimi i publikimit të buletinit elektronik nga Gjykata e Lartë 3.6 Përmirësimi i shërbimeve ndaj publikut

Shtylla	Funksioni dhe objektivat konkretë
<i>SHTYLLA IV</i> <i>NDËRVEPRIMI ME KOMUNITETIN DHE RRITJA E BESIMIT TË PUBLIKUT</i>	<i>Zbatimi praktik i komunikimit ndëreveprues dhe edukimit ligjor të parashikuar në Planin Strategjik.</i>
 04 NDËRVEPRIMI ME KOMUNITETIN DHE RRITJA E BESIMIT TË PUBLIKUT	4.1 Institucionalizimi i organizimit vjetor të Javës së Drejtësisë 4.2 Afrimi me qytetarin, OSHC-të, median e aktorë të tjerë të interesuar nëpërmjet mbajtjes së ditëve të hapura në gjykata 4.3 Rritja e edukimit ligjor të publikut nëpërmjet bashkëpunimit me studentë, OSHC, media e aktorë të tjerë të interesuar 4.4 Përdorimi i mjeteve të komunikimit si tryeza të rumbullakëta apo konferenca publike për të përçuar mesazhet mbështetëse 4.5 Institucionalizimi i bashkëpunimit me OSHC-të nëpërmjet zhvillimit të takime periodike 3 mujore 4.6 Institucionalizimi i bashkëpunimit me median, OSHC-të apo aktorë të tjerë nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit

Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi

Suksesi i zbatimit të këtij Plani Komunikimi ndërvaret nga jetësimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi periodik të zbatimit konkret të tij. Në kuadër të zbatimit dhe monitorimit, secila gjykatë duhet të caktojë një pikë kontakti për këtë qëllim, i cili mund të jetë gjyqtari, nëpunësi për marrëdhënien me median dhe publikun/ koordinatori i të drejtës së informimit ose çdo person tjetër i përcaktuar prej tyre me funksionet e marrëdhënies me median dhe publikun.

Pika e kontaktit do të paraqesë çdo 3 muaj, raportin e realizimit dhe ecurisë së zbatimit të Planit, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas formatit të unifikuar të raportit, shtojcë e këtij Plani. Monitorimi do të mbështetet në progresin e zbatimit të çdo aktiviteti të parashikuar në Planin e Veprimit duke ndjekur rregullisht zbatimin e aktiviteteve sipas përshkrimit, afatin e realizimit të tyre dhe përmbushjen e indikatorëve të parashikuar. Qëllimi i këtij monitorimi është adaptimi/përmirësimi i planit në varësi të kushteve, rrethanave apo nevojave që gjykatave mund t'i lindin gjatë kohës së zbatimit të tij. Gjykatat në raportin e monitorimit të realizimit të Planit do të paraqesin edhe vështirësitë dhe rekomandimet për përmirësim apo rishikim.

Anëtari përgjegjës për marrëdhënien me median dhe publikun pranë KLGJ, do të raportojë çdo vit mbi ecurinë e zbatimit të Planit dhe do të koordinojë bashkërendimin e aktiviteteve përmes zhvillimit të takimeve periodike të pikave të kontaktit. Këto takime do të synojnë nxitjen e gjykatave për një qasje proaktive për marrëdhëniet me publikun dhe median, shmangien e mbivendosjes së aktiviteteve dhe prodhimit të materialeve informuese mes gjykatave, si dhe sigurimin e një lidhje harmonike të këtij Plani Komunikimi me politikat strategjike që ka Këshilli për sa i përket komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.

Vlerësimi i impaktit të Planit të Komunikimit, gjatë zbatimit të tij dhe në fund, do të mbështetet në indikatorët e performancës dhe të impaktit të parashikuar për çdo objektiv. Indikatorët mund të përditësohen në vijimësi në varësi të zhvillimeve që mund të ndodhin në sistemin gjyqësor.

Mesazhet kryesore mbështetëse të planit të komunikimit

Gjykatat dhe KLGJ në informimin e publikut dhe aktorëve të tjerë duhet të udhëhiqen nga mesazhet e mëposhtme të cilat mund të shërbejnë si modele për përcjelljen e informacionit sipas formave apo kanaleve të komunikimit që do të zgjidhen të përdoren.

Komunikim efikas dhe i shpejtë mes palëve të interesit dhe gjykatave për të garantuar transparencë në veprimtarinë e gjykatave dhe informimin e publikut.

Sistemi gjyqësor është i përkushtuar për të garantuar transparencë dhe informim të publikut përmes përdorimit të platformave të reja të komunikimit të cilat mundësojnë informacion të shpejtë dhe akses në çdo kohë për të gjithë qytetarët.

Të njihemi me gjykatat dhe procedurat gjyqësore! Gjykatat garantojnë informim cilësor dhe në kohë të publikut përmes ofrimit të informacioneve të thjeshta, praktike dhe të përditësuara mbi veprimtarinë e tyre, shërbimet dhe procedurat gjyqësore.

Publiku ka të drejtë të informohet nëpërmjet çdo kanali komunikimi që gjykatat disponojnë, mbi të drejtat e tyre, afatet ligjore, procedurat dhe dokumentacionet përkatëse, si dhe çdo informacion tjetër lidhur me garancitë e tyre ligjore.

Grupet në nevojë kanë akses në gjykata dhe në shërbimet që ofrojnë ato duke përfituar kështu drejtësi efektive njëlloj si çdokush tjetër!

Të gjithë individët, pjesë e grupeve vulnerabël dhe/ose me të ardhura të pamjaftueshme që nuk kanë mundësi t'i drejtohen një avokati për të zgjidhur problematikën e tyre ligjore, përfitojnë ndihmë ligjore falas, të garantuar nga shteti.

Rritja e transparencës së sistemit gjyqësor, ofrimi i shërbimeve në kohë dhe me efikasitet, edukimi i qytetarëve për sundimin e ligjit dhe sistemin e drejtësisë mbështeten tek

ndërveprimi i gjykatave me publikun. Të gjithë së bashku do të rikthejmë besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Sjellim gjykatën me afër komunitetit! Çdo anëtar i komunitetit ka të drejtë të njihet me rolin dhe misionin e gjykatës në shoqëri. Afrimi me komunitetin përmes fushatave të mirëmenduara, planifikuara dhe organizuara, rrit nivelin e njohjes dhe informimit të publikut mbi sistemin gjyqësor.

Zvogëlimi i hendekut mes komunitetit dhe gjykatave i shërben më së miri rikthimit të besimit tek sistemi gjyqësor.

Plani i Veprimeve dhe Treguesit e Performancës

PLANI I VEPRIMIT			
SHTYLLA I	<i>Qeverisja dhe koordinimi i komunikimit të gjykatave</i>		
OBJEKTIVI 1.1	Ndjekja e ecursisë së zbatimit uniform të Udhëzuesit për marrëdhëniet me publikun dhe median nga ana e gjykatave dhe KLGJ		
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/Struktura e Përfshirë
•Përgatitja e përmbledhjeve 3 mujore për secilën gjykatë • 1 raport monitorimi vjetor i zbatimit të udhëzimit standard për shtypin i publikuar	Koordinimi, mbledhja e statistikave dhe informacioneve të nevojshme nga pikat e kontaktit në lidhje me zbatimin e udhëzuesit nga gjykatat	2025-2027	Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Botimet në KLGJ
OBJEKTIVI 1.2	Institucionalizimi i figurave/roleve kryesore dhe zbatimi standard i përgjegjësi (Gjyqtari i Medias, Nëpunësi i Marrëdhënieve me Median dhe Publikun (NMMP), Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP		
•Të paktën 1 trajnim në vit	Trajnim për anëtarin përgjegjës të KLGJ-së për marrëdhëniet me publikun dhe median, gjyqtarët e medias, administratën e KLGJ-së, si dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të angazhuar me aktivitetet e marrëdhënieve me publikun	2025-2027	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në KLGJ
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 1.3	Bashkërendimi i aktiviteteve përmes zhvillimit të takimeve 3mujore të pikave të kontaktit dhe Anëtarit të KLGJ për MMP		

•Të paktën 1 takim çdo 3 muaj	Organizimi i takimeve periodike 3 mujore ndërmjet pikave të kontaktit dhe Anëtarit të KLGJ për MMP	2025-2027	Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Botimet në KLGJ
OBJEKTIVI 1.4	Ndjekja e ecurisë së zbatimit të Planit përmes raportimit vjetor të Anëtarit të KLGJ		
• 1 raport monitorimi vjetor	Raportimi dhe publikimi i raportit vjetor për ecurinë e zbatimit të planit të komunikimit në sistemin gjyqësor	2025-2027	Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Botimet në KLGJ
OBJEKTIVI 1.5	Garantimi i burimeve buxhetore për financimin e aktiviteteve të Planit		
• 1 raport vlerësimi të nevojave i përgatitur	Vlerësimi i nevojave buxhetore për financimin e aktiviteteve të parashikuara në zbatim të planit të komunikimit nga ana e gjykatave	Janar – Mars 2026	Drejtoria e Programit dhe Monitorimit të Buxhetit
•% e përfshirjes në buxhetin vjetor të gjykatave të aktiviteteve të planit të komunikimit	Parashikimi i nevojave buxhetore në buxhetin e sistemit gjyqësor dhe gjykatave përkatëse	2026	KLJGJ Drejtoria e Programit dhe Monitorimit të Buxhetit në KLGJ Drejtoret e Buxhetit në Gjykata
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 1.6	Koordinimi i qëndrimeve publike për çështje me interes publik ndërmjet KLGJ dhe gjykatave		
•Numri i çështjeve me interes të veçantë publik të koordinuara	Gjyqtari i medias koordinon veprimtarinë me Anëtarin e KLGJ përgjegjës për MMP në rastet me interes të veçantë publik	2025-2027	Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP Drejtoria e Marrëdhënieve me

			Publikun, Median dhe Botimet në KLGJ
•Numri i deklaratave publike të publikuara	Bashkëpunimi për përgatitjen e deklaratave publike ndërmjet gjyqtarit të medias dhe Anëtarit të KLGJ përgjegjës për MMP për mbajtjen e qëndrimeve publike në mbrojtje të gjyqtarëve të veçantë, në zbatim të ligj	2025-2027	Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtar i KLGJ përgjegjës për MMP Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Botimet në KLGJ
OBJEKTIVI 1.7	Bashkërendimi KLGJ – gjykatë i komunikimit në situata kritike		
•Numri i deklaratave publike të publikuara	Bashkëpunimi i gjyqtarit të medias me anëtarin e KLGJ-së përgjegjës për MMP sipas parashikimeve të udhëzuesit dhe përgatitja e deklaratave përkatëse	2025-2027	Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtar i KLGJ përgjegjës për MMP Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Botimet në KLGJ
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 1.8	Diskutimi i çështjeve të marrëdhënieve me median dhe publikun në takimet periodike të lidhshëm të gjykatave		
•Numri i çështjeve në lidhje me MMP të trajtuara në takimet periodike të lidhshëm	Përfshirja në rendin e ditës të çdo takimi të lidhshëm të raportimit të ecjes së zbatimit të planit, çështje me interes të veçantë për standardizim nga KLGJ apo çështje të tjera që lidhen me marrëdhëniet me publikun dhe median	2026-2027	Drejtoria përgjegjëse për organizimin e takimeve të lidhshëm në KLGJ
SHTYLLA II	Transparenca dhe informimi i publikut		
OBJEKTIVI 2.1	Publikimi i informacionit pa kërkesë (procedura, shërbime, struktura) sipas parashikimeve në Udhëzues		
•Faqe e internetit e përditësuar dhe	Publikimi i informacionit pa kërkesë (procedura, shërbime,	2025-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me

materialet e publikuara sipas kërkesave të udhëzuesit	struktura) sipas parashikimeve në Udhëzues		publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
Numri i gjykatave që kanë publikuar online fletëpalosje videon për shërbimet e ofruara	Përgatitja dhe publikimi online i një fletëpalosje dhe një video për shërbimet e ofruara;	2026-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP Operatori ekonomik
Numri i gjykatave që kanë publikuar online video turin	Realizimi dhe publikimi i një video “Turi virtual i gjykatës” duke paraqitur gjykatën dhe ambientet e saj (sportelet, sallat e gjyqit, siguria, kodin e sjelljes, infrastrukturën për PAK, etj.)	2026-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP Operatori ekonomik
OBJEKTIVI 2.2	Informimi në gjuhë të thjeshtë për procedurat gjyqësore		
- Hartimi dhe publikimi i tre broshurave online (penale, civile dhe procedura administrative) të përshtatura për secilën gjykatë - Publikimi në faqen e internetit të formateve	Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese mbi procedurën që ndiqet në çështjet penale, civile dhe ato administrative; mënyrën e paraqitjes së çështjeve, kërkesave/ankesave drejtuar gjykatës; formatet standarde; mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve	2026-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP

standarde të akteve dhe kërkesave që i drejtohen gjykatës	(ndërmjetësimi); shërbimet që mund të merren nga Gjykata; e drejta e ankimit/rekursit dhe afatet		Operatori ekonomik
•Përgatitja dhe publikimi online i dy fletëpalosje mbi të drejtën e ankimit dhe rekursit; • Përgatitja dhe publikimi i një fletëpalosje dhe një video online për ndërmjetësimin			
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 2.3	Informimi mbi ndihmën juridike dhe tarifat gjyqësore		
• Numri i materialeve informuese mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti;	Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti.	2026-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtar i KLGJ përgjegjës për MMP
• Numri i materialeve informuese mbi tarifat gjyqësore	Hartimi dhe publikimi i materialit informues, online dhe i printuar mbi tarifat gjyqësore;	2026-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtar i KLGJ përgjegjës për MMP
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 2.4	Informimi i përshtatur për të mitur, PAK, grupe në nevojë		
•Numri i materialeve informuese mbi të drejtat e të miturve në	Përgatitja e materialeve informuese mbi të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin gjatë	2026-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me

konflikt me ligjin gjatë procesin penal dhe të drejtat e të miturve viktimë ose dëshmitarë të veprës penale;	procesit penal dhe të drejtat e të miturve viktimë ose dëshmitarë të veprës penale dhe publikimi i tyre		publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median Anëtarë i KLGJ përgjegjës për MMP
OBJEKTIVI 2.5	Informimi i publikut për masat e marra për rritjen e efikasitetit të pushtetit gjyqësor		
• Publikimi në faqet përkatëse	Publikimi i udhërrëfyesit në faqet web të KLGJ, gjykatave dhe rrjetet sociale		KLGJ Gjykatat
• Dy takime, një çdo vit mbi raportin e progresit të Udhërrëfyesit	Prezantimi i Udhërrëfyesit dhe raportimi i progresit në takime të përbashkëta me përfaqësues të gjykatave, institucioneve partnere, OSHC-ve dhe medias	2026-2027	KLGJ Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Botimet në KLGJ
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 2.6	Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies duke publikuar rezultatet e arritura		
• Dy raporte vjetore të publikuara në faqen zyrtare të KLGJ	Publikimi i analizave vjetore mbi nivelin zbatueshmërisë të objektivave të Udhërrëfyesit mbi Efikasitetin	2026-2027	KLGJ Departamenti i Administrimit të Gjykatave & Teknologjisë së Informacionit
SHTYLLA III	<i>Kanalet dhe teknologjia e komunikimit</i>		
OBJEKTIVI 3.1	Rritja e aksesit në kohë reale në informacion nëpërmjet administrimit dhe përditësimit të faqeve zyrtare të internetit		
• numri i rubrikave të publikuara për secilën gjykatë	Krijimi dhe/ose përditësimi i rubrikave të veçanta në faqen www.gjykata.gov.al dedikuar		Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë

• Rreth 200 klikime në portalin online	publikimit të informacioneve për qytetarët.		Nëpunësi përgjegjës për teknologjinë e informacionit në gjykatë Drejtoria IT-së dhe Menaxhimit të Çështjeve në KLGJ
• numri i rubrikave të publikuara për secilën gjykatë	Krijimi dhe/ose përditësimi i rubrikës “Pyetje të shpeshta” (FAQ)	Janar – Mars 2026	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i Medias Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 3.2	Institucionalizimi i përdorimit të rrjeteve sociale nëpërmjet hartimit të media-planeve vjetore për rrjetet sociale		
• të paktën 1 llogari në 1 rrjet social për secilën gjykatë	Plotësimi ose përditësimi periodik i llogarive në rrjete sociale, Facebook, LinkedIn dhe Twitter për secilën Gjykatë.	2025-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i Medias Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP
• të paktën 1 media plan për gjykatë në vit	Hartimi dhe zbatimi i media-planeve për publikimet në rrjetet sociale të Gjykatave.	2025-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Gjyqtari i Medias Anëtari i KLGJ përgjegjës për MMP
OBJEKTIVI 3.3	Rritja e përçimit të informacionit nëpërmjet përgatitjes dhe përdorimit të videove shpjeguese, tutoriale, njoftime të shkurtra etj.		
•Numri i videove shpjeguese dhe udhëzuesve mbi mënyrën e kërimit dhe	Përgatitja dhe publikimi i videove shpjeguese dhe udhëzuese mbi mënyrën e kërimit dhe marrjes	2026-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë

marrjes së informacionit në faqen/et e internetit të Gjykatave •Numri i publikimeve në faqen e internetit/ rrjetet sociale të KLGJ •Numri i publikimeve në faqen e internetit/ rrjetet sociale të grupeve të interesit	së informacionit në faqen www.gjykata.gov.al; rrjetet sociale apo fizikisht në gjykatë Publikimi në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të KLGJ dhe grupeve të interesit.		Nëpunësi përgjegjës për teknologjinë e informacionit në gjykatë Drejtoria IT-së dhe Menaxhimit të Çështjeve në KLGJ Operatorë ekonomikë
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 3.4	Promovimi i mënyrave të përfthimit të informacionit gjyqësor përmes përdorimit të QR, posterave dhe mënyrave të tjera digjitale		
• Numri i posterave për të promovuar faqet e internetit dhe rrjetet sociale të gjykatave. • Numri i institucioneve në të cilët janë vendosur postera për të promovuar faqet e internetit dhe rrjetet sociale të gjykatave.	Promovimi i faqes së internetit të Gjykatave dhe rrjeteve sociale të Gjykatave nëpërmjet përdorimit të mjeteve të tilla si QR, postera apo mënyra të tjera bashkëkohore digjitale Printimi i posterave me kode QR nga secila gjykatë dhe përmbajnë informacion mbi faqen e internetit/rrjeteve sociale të Gjykatës Vendosja e posterave në institucione me frekuencim të gjerë nga qytetarët.	2026-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Nëpunësi përgjegjës për teknologjinë e informacionit në gjykatë Drejtoria IT-së dhe Menaxhimit të Çështjeve në KLGJ Operatorë ekonomikë
OBJEKTIVI 3.5	Vijimi i publikimit të buletinit elektronik nga Gjykata e Lartë		
• Numri i buletineve elektronike të publikuara nga Gjykatës së Lartë.	Publikimi çdo tre muaj i buletinit elektronik në të cilën trajtohen çështje që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, ndryshimet në legjislacion, vendime unifikuese, statistika etj.	2025-2027	Nëpunësi përgjegjës për marrëdhënien me publikun dhe median në gjykatë Nëpunësi përgjegjës për teknologjinë e informacionit në gjykatë

Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 3.6	Përmirësimi i shërbimeve ndaj publikut		
• Struktura e vërtetimit e plotësuar dhe metodologjia e miratuar	Miratimi i strukturës standarde të sondazhit të vërtetimit dhe metodave për kryerjen e tij.	Janar – Mars 2026	KLGJ Departamenti i Administrimit të Gjykatave & Teknologjisë së Informacionit në KLGJ
• Minimumi 13 vërtetime të zhvilluara në gjykata të ndryshme në vit • Rezultatet e vërtetimit për vlerësimin e shërbimeve të gjykatave nga përdoruesit e tyre të publikuara çdo vit	Vijimi i zhvillimit të vërtetimeve për vlerësimin e shërbimeve të gjykatave nga përdoruesit e tyre dhe publikimi i rezultateve të tyre	2026-2027	KLGJ Departamenti i Administrimit të Gjykatave & Teknologjisë së Informacionit në KLGJ
SHTYLLA IV	<i>Ndërveprimi me komunitetin dhe rritja e besimit të publikut</i>		
OBJEKTIVI 4.1	Institucionalizimi i organizimit vjetor të Javës së Drejtësisë		
• Numri i gjykatave të angazhuara në organizimin e “Javës së Drejtësisë”; • Numri i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjëse për “Javën e Drejtësisë”;	Organizimi i aktiviteteve publike apo fushatave ndërgjegjëse në kuadër të 10 Majit, Ditës Kombëtare të Drejtësisë. Aktivitetet synohen të shtrihen përgjatë gjithë javës së parë të muajit maj, duke e cilësuar këtë si “Java e Drejtësisë”. Përgatitja dhe publikimi i kalendarit të aktiviteteve sipas Gjykatave të paktën 3 muaj përpara Javës së Drejtësisë; Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe grupet e interesit (OSHC-të, universitetet,	2026-2027	KLGJ Gjykatat Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Botimet në KLGJ

	media etj) për zbatimin e kalendarit të aktiviteteve.		
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
Numri i materialeve informuese për “Javën e Drejtësisë” të publikuara.	Përgatitja e materialeve promovuese për “Javën e Drejtësisë” Krijimi i Logos identifikuese dhe përcaktimi i sloganit të Javës së Drejtësisë; Printimi dhe vendosja e materialeve promovuese si postera, baner, Tshirts, stema etj, në ambientet e secilës Gjykatë; Krijimi dhe përdorimi i Hashtag-ut (#) të "Javës së Drejtësisë" për të gjithë postimet në rrjete sociale nga KLJG dhe gjykatat; Krijimi dhe publikimi i videos promovuese të aktiviteteve të "Javës së Drejtësisë".	2026-2027	KLJG Gjykatat Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe Botimet në KLJG Departamenti i Administrimit të Gjykatave & Teknologjisë së Informacionit në KLJG
OBJEKTIVI 4.2	Afrimi me qytetarin, OSHC-të, median e aktorë të tjerë të interesuar nëpërmjet mbajtjes së ditëve të hapura në gjykata		
Numri i gjykatave që organizojnë ditët e hapura	Organizimi i Ditës së Hapur në çdo Gjykatë;	2026-2027	KLJG Gjykatat
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 4.3	Rritja e edukimit ligjor të publikut nëpërmjet bashkëpunimit me studentë, OSHC, media e aktorë të tjerë të interesuar		
Numri i aktiviteteve të organizuara	Zhvillimi i aktiviteteve informuese me qytetarë, grupe në nevojë, nxënës/të rinj, gra/vajza, etj. të organizuara në bashkëpunim me OSHC-të mbi tematika me interes për publikun (psh: ndihma juridike		KLJG Gjykatat

	e garantuar nga shteti, tarifat gjyqësore, dhuna në familje, urdhrat e mbrojtjes, çështje të pronësisë, drejtësia penale për të mitur, etj.)		
OBJEKTIVI 4.4	Përdorimi i mjeteve të komunikimit si tryeza të rrumbullakëta apo konferenca publike për të përçar mesazhet mbështetëse		
•të paktën 1 aktivitet për vit akademik me studentët e Fakultetit të Drejtësisë	Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere me studentë të Fakulteteve të Drejtësisë (gjyqe imituese) që trajtojnë tematika me interes për qytetarët.	2026-2027	KLJG
•të paktën 2 takime në vit me gazetarë që mbulojnë fushën e drejtësisë dhe të paktën 1 leksion i hapur në vit në Fakultetet e Gazetarisë	Aktivitete informuese me median (tryeza, leksione) dhe studentët e gazetarisë që trajtojnë tema me interes për rolin e medias dhe gjyqësorin	2026-2027	KLJG
Treguesit e performancës	Aktiviteti kryesor	Planifikimi kohor	Institucioni Përgjegjës/ Struktura e Përfshirë
OBJEKTIVI 4.5	Institucionalizimi i bashkëpunimit me OSHC-të nëpërmjet zhvillimit të takime periodike 3 mujore		
• Numri i tryezave të mbajtura me OSHC-të dhe grupet e interesit	Tryezë diskutimi me OSHC-të dhe grupet e interesit me qëllim forcimin e bashkëpunimit të paktën çdo 3 muaj	2026-2027	KLJG
	Bashkëpunimi ndërmjet KLJG/Gjykata me OSHC dhe grupet e tjera të interesit për përgatitjen e materialeve të tjera informuese	2026-2027	KLJG
OBJEKTIVI 4.6	Institucionalizimi i bashkëpunimit me median, OSHC-të apo aktorë të tjerë nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit		

	Hartimi i formateve standard të marrëveshjeve të bashkëpunimit me OSHC dhe aktorë të tjerë	Janar – Mars 2026	KLJGJ
Numri i marrëveshjeve të lidhura me OSHC-të dhe grupet e interesit	Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me OSHC dhe aktorë të tjerë	2026-2027	KLJGJ

Shtojca 1

Formati i raportit 3 mujor për monitorimin dhe zbatimin e Planit të Komunikimit

1. Gjykata

Shënim: Vendorsni gjykatën përkatëse

2. Periudha e Raportimit

Shënim: Duhet të evidentojë periudhën 3 mujore të zbatimit të aktiviteteve

3. Progresi i zbatimit të Objektivi dhe aktiviteteve përkatëse

Shembull (Shtoni objektivat, hapat dhe veprimet konkrete sipas Planit të Veprimit)

Objektivi nr.1: Informimi i publikut dhe të promovimi i rezultateve të arritura deri më sot për sistemin gjyqësor nga zbatimi i Reformës në Drejtësi;

Hapi	Veprimi	Afati i zbatimit	Zbatuar (po/jo)	Njësia Matëse
1.1 Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme lidhur me riorganizimin e kompetencave tokësore të gjykatave.	✓ Publikimi online i grafikës informuese për secilën gjykatë, që përmban shpjegimin mbi kompetencën tokësore, numrin e gjyqtarëve, infrastrukturën, largësinë, etj.;			Numri i grafikës informuese

Shpjegime të mëtejshme për çdo hap dhe veprim:

Shënim: Raportimi duhet të përfshijë progresin e zbatimit të çdo objektivi të parashikuar në Planin e Veprimit duke ndjekur rregullisht zbatimin sipas përshkrimit, afatin e realizimit të tyre dhe përmbushjen e indikatorëve të parashikuar.

4. Vështirësitë për përmbushjen e objektivave

5. Rekomandime për përmirësimin e objektivave, hapave dhe aktiviteteve konkrete